



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE

**LOCAL GOVERNANCE  
PROGRAM IN ALBANIA**

## HISTORI SUKSESI

Komitetet e Rritjes së Ekonomisë Vendore realizojnë forumin publik-privat për një diskutim të hapur dhe për të vlerësuar strategjitë e bashkive për rritjen e ekonomisë vendore



*Tre anëtarë të Komitetit të Rritjes së Ekonomisë Vendore të Fierit duke hartuar planin e veprimit për rritjen e ekonomisë vendore të qytetit të tyre.*

**Komitetet e Rritjes së Ekonomisë Vendore në 10 qytetet e synuara të Programit të Qeverisjes Vendore në Shqipëri hartuan një vizion strategjik për të ardhmen e mundësive për rritjen e ekonomisë vendore dhe si përcaktuan përparësitë për veprime të menjëhershme brenda kuadrit të planit afatshkurtër të veprimit për zhvillimin e ekonomisë vendore. Ky plan dhe veprimtaritë pasuese për zbatimin e tij ishin një rezultat i bashkërendimit midis stafit të Projektit LGPA, punonjësve të bashkisë si dhe organizmave të tjerë aktivë në bashkitë përkatëse.**

**Planet e veprimit të këtyre Komitete kanë patur sukses në gjetjen e burimeve për ndryshim: si mesatare, pesë deri në 6 veprime u vunë në zbatim në secilin qytet gjatë vitit të parë të Projektit LGPA.**

Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri, i USAID-it, po përdor procesin e pjesëmarrjes duke u mbështetur në përfshirjen e komunitetit të biznesit vendas dhe grupeve të shoqërisë civile, për të punuar bashkërisht me punonjësit dhe personelin e bashkisë, me qëllim nxitjen e rritjes së ekonomisë vendore dhe përmirësimin e cilësisë së qeverisjes vendore.

Pas nënshkrimit në janar të vitit 2008 të Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis dhjetë bashkive të përfshira në Programin LGPA (Shkodra, Kukës, Lezhë, Fushë-Krujë, Gramsh, Pogradec, Korçë, Librazhd, Fier dhe Himarë), secila bashki ngriti një Komitet dypalësh dhe me pjesëmarrje për Rritjen e Ekonomisë Vendore për të punuar së bashku me Programin LGPA gjatë tre viteve të fundit të projektit.

Këto komitete u mblodhën për herë të parë në shkurt të vitit 2008. Si detyrë të parë të tyre, komitetet vlerësuan dhe evidentuan faktorët kryesorë që duhet të trajtohen me qëllim bashkërendimin dhe inkurajimin e rritjes së ekonomisë vendore. U diskutuan çështje si evidentimi dhe disponueshmëria e burimeve njerëzore dhe natyrore, gjendja ekonomike e bashkive, mjedisi kulturor dhe shoqëror i qyteteve përkatëse, si dhe përparësitë për përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Përveç kësaj, gjatë takimeve të punës u trajtuan edhe çështje që kanë të bëjnë me reformën administrative në fushën e mbledhjes së taksave, hartimit të buxhetit, administrimit financiar dhe të pronave, si dhe prokurimit publik që do të ndihmojnë për të krijuar një mjedis “miqësor për biznesin” dhe për të tërhequr investime të reja.

Komitetet do të mblidhen përsëri vazhdimisht për të shqyrtuar përparimin e arritur deri tani si dhe për të rishikuar planin fillestar të veprimit, sipas nevojave. Anëtarë të caktuar të komiteteve pritet që të marrin përgjegjësi për zbatimin e elementëve të rëndësishëm të planit të veprimit. Fushat kryesore për të ndërhyrë që u përcaktuan në planet e veprimit janë: krijimi i imazhit të qyteteve, zhvillimi i turizmit, planifikimi urban, agrobiznesi, hartimi i buxhetit me pjesëmarrje, administrimi i taksave, administrimi i pronave publike si dhe përmirësimi i shërbimeve publike.